



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600603/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandojmë marrjen e masave për shpejtimin e gjykimit të dosjes gjyqësore me Paditës A. P. kundra të paditurit Z.V.R.P.P. Elbasan ardhur për gjykim me datën 15.09.2015.*

Drejtuar : **Z.Kastriot SELITA**
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 29.03.2016, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi A. P. nga qyteti i Elbasanit ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore nga Gjykata Administrative të Apelit Tiranë, në gjykimin e një çështje gjyqësore me paditës Albert Paja dhe e Paditur ZVRPP Elbasan me objekt anulim i urdhërit Nr.3 datë 28.01.2009 për sipërfaqen e truallit prej 113 m2 dhe detyrimin e ZVRPP Elbasan të regjistrojë truallin në emër të paditësit A. P.

Nga ankesa del se ankuesi A. P. na shkruan se me vendimin gjyqësor Nr.727 datë 10.06.2015 Gjykata Administrative e shkallës së parë Durrës, ka vendosur pranimin e padisë, Kundra këtij vendimi është ankuar pala e paditur dhe dosja e tij tani ndodhet për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Në këtë Gjykatë dosja e tij ndodhet e regjistruar për gjykim me Nr.31016-05716-86-2015 akti, datë 15.09.2015, dhe si relatore është caktuar Zj.A.Selimi e cila nuk ka planifikuar akoma datën dhe orën e gjykimit të kësaj çështje ndërkohë që ankuesi A. P. nga ana e tij kërkon shpejtimin e gjykimit të kësaj çështje duke u bazuar në parimet e përgjithshme të gjykimit administrativ.

Sipas nenit 3 të Ligjit Nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", parashikohet sigurimi i një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qënë edhe qëllimi i ligjvënësit me rastin e krijimit të këtyre gjykatave. Ligji synon thjeshtimin e procedurave ligjore me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe qëllimi i krijimit të gjykatave administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të së drejtës të subjekteve dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme.

Në nenin 48/2 të Ligjit Nr.49/2012, thuhet se :” Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga dita e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj me vendimet gjyqësore me Nr.69/2015, Vendimi me Nr.81/2015, dhe vendimi Nr.14/2016, ka pranuar se çështjet gjyqësore kur paraqiten për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit duhet të përfundojnë së gjykuari brenda afatit 30 ditor, ndryshe atyre u cënohet parimi i gjykimit për një proces të rregullt gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

Në këto kushte kur dosja e ankuesit A. P. ndodhet e regjistruar për gjykim me datë 15.09.2015, dhe ajo deri tani nuk është caktuar akoma gjykimi i saj ka vend të ndërhyhet me rekomandim për marrjen e masave për shpejtimin e këtij gjykimi në të ardhmen. Në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, thuhet se:”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”, dhe në nenin 21/c të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit, ku thuhet se, Avokati i Popullit, pas përfundimit të hetimit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”.

Për sa më sipër ju,

REKOMANDOJMË :

1.Marrjen e masave për shpejtimin e gjykimit të çështjes gjyqësore me paditës A. P. dhe e paditur ZVRPP Elbasan, ardhur për gjykim në Gjykatën Administrative Apelit me datë 15.09.2015.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj lutemi na ktheni përgjigje me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI